

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
IDENTITEK SHA
DIVIZIONI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 03.08.2026

Proces - Verbal - Tipi i kontratës – Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kondicionerë për zyra”

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,331,833.33 (tre milion e treqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) **Lekë (pa TVSH)**

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ”Identitek” Sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- 1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 9001:2015** (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 14001:2015** (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: *Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët*

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik të paraqesë **katalog teknik të mallit**, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DT.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht”... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) fotografite apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpuetshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi i pajisjeve, ose nga Distributori i Autorizuar, që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së pajisjeve, për një periudhë jo më pak se 24 muaj.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi i pajisjeve ose nga distributori i autorizuar, e cila garanton mbulimin e periudhës së garancisë së pajisjeve për jo më pak se 24 (njëzet e katër) muaj, vendoset për të siguruar që pajisjet e ofertuara mbështeten drejtpërdrejt nga zinxhiri zyrtar i prodhuesit dhe se garancia është e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kërkuar. Kjo kërkesë synon të garantojë se, në rast defektesh apo mosfunksionimi të pajisjeve, autoriteti kontraktor do të përfitojë shërbim garancie, zëvendësim të pjesëve, përditësime të nevojshme dhe mbështetje teknike në përputhje me politikat zyrtare të prodhuesit. Një deklaratë e tillë minimizon rrezikun e furnizimit me pajisje që nuk mbulohen nga garancia zyrtare, janë të importuara jashtë kanaleve të autorizuara ose nuk mbështeten nga rrjeti i prodhuesit. Periudha minimale prej 24 muajsh konsiderohet standard i pranueshëm në treg, duke siguruar një periudhë të mjaftueshme funksionimi të qëndrueshëm të pajisjeve dhe mbrojtje të investimit të Autoritetit Kontraktor.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **17.08.2026**; Ora: **12:00**; Vendi: “IdentiTek” Sh.A, Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.